



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/11  
Datë: 07.05.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 maj 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitet 2021 - 2025 me shtojcat Programi Legjislativ për vitin 2021 dhe Planet Strategjike dhe Operacionale të Ministrive.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitet 2021 - 2025 me shtojcat nga pika 1. e këtij vendimi t'i procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/11

Datë: 07.05.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 dhe nenit 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 paragrafi 2 nënparagrafi 2.4, të nenit 10 paragrafin 2 nënparagrafi 2.4 dhe nenit 12 të Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe në zbatim të nenit 89 të Ligjit Nr.04/L-125 për Shëndetësi dhe Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/11, datë 15.03.2020 për Shpalljen e Emergjencës për Shëndetin Publik dhe në zbatim të rekomandimeve të IKSHPK-së, me qëllim të kontrollit, parandalimit dhe luftimit të përhapjes së virusit SARS-CoV-2, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 maj 2021 merr këtë:

**V E N D I M**

**Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për masa të përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19**

1. Shtohet një pikë e re 3A në Vendimin Nr. 01/07, të datës 18.04.2021, si në vijim:

**3A.** Ndalohet hyrja në Republikën e Kosovës për personat që vijnë nga India, Brazili dhe Afrika e Jugut.

**3A.1** Shtetasit e Republikës së Kosovës të cilët vijnë nga India, Brazili dhe Afrika e Jugut duhet të karantinohen në shtëpitë (vendin e banimit) e tyre për katërmbëdhjetë (14) ditë duke u testuar dy herë në javë.

**3A.2** Pika 3A.1 nuk vlen për shtetasit e Republikës së Kosovës të cilët qëndrojnë transit (më pak se 48 orë) në shtetet e përcaktuara në pikën 3A.1 të këtij vendimi.

**3A.3** Diplomatët e huaj si dhe familjarët e tyre përjashtohen nga fushëveprimi i pikës 3A të këtij vendimi.


2. Udhëzohen Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës si dhe Ministria e Punëve të Brendshme të marrin vendimet dhe veprimet e nevojshme në përputhje me fushat e përgjegjesisë administrative të tyre me qëllim të zbatimit të këtij Vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

## Arsyetim

Duke marrë parasysh situatën aktuale epidemiologjike në botë, shfaqjen e varianteve të reja të COVID-19, në Indi, Brazil dhe Afrikë të Jugut, rrezikun e bartjes së varianteve të reja nga udhëtimet prej këtyre shteteve, për parandalimin e ardhjes së varianteve të reja u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

### Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Komunave
- Inspektorateve përgjegjëse
- Policisë së Kosovës
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/11  
Datë: 07.05.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 14 (3) të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 në Territorin e Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-194, Ligjit Nr. 06/L-021 Për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike (LKMFP), duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 maj 2021, merr këtë:


**V E N D I M**

1. Delegohet kompetenca e Qeverisë së Republikës së Kosovës e përcaktuar me paragrafin 3. të nenit 14 të Ligjit Nr.07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021 tek Ministria e Shëndetësisë, për qëllimet e përcaktuara në pikën katër (4) të këtij Vendimi.
2. Autorizohet Ministri dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, që bashkërisht të caktojnë lartësinë e paradhënies së aplikueshme dhe aprovojnë pagesat në emër të paradhënies, sipas pikës 1. të këtij vendimi, e kufizuar në ndarjet buxhetore.
3. Lartësia e paradhënies nga pika 2. e këtij vendimi përcaktohet në përputhje me kushtet e marrëveshjes së furnizimit, me vendim të veçantë, për secilin rast individualisht.
4. Delegimi nga ky vendim vlen vetëm dhe ekskluzivisht për procesin e pagesës së furnizimit me vaksinat për 'Covid-19', nga prodhuesit - operatorët ekonomik më të cilët arrin marrëveshje Ministria e Shëndetësisë, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.
5. Ky autorizim është i vlefshëm deri në nëntor të vitit 2021, kur sipas paragrafit 4, të nenit 14. të Ligji Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, paradhëniet kufizohen në 10%, përkatësisht 5%.
6. Paradhëniet (avancet) e ndodhura (ekzekutuara) para afatit sipas pikës 5. të këtij vendimi, mund të mbeten të hapura pjesërisht apo plotësisht, përtej vitit fiskal 2021, varësisht nga dinamika e furnizimit me vakcina.
7. Obligohet Ministria e Shëndetësisë që me rastin e pranimit të faturës dhe dërgesës së vaksinave, përkatësisht gjatë procesit të pagesës së faturave të furnizimit, t'i jap prioritet fillimisht mbylljes (përkatësisht arsyetimit) të paradhënies sipas rregullave të Thesarit në fuqi, përveç rasteve kur kjo është e pamundur objektivisht.



8. Për paradhëniet e mbetura të hapura në fund të vitit fiskal 2021, sipas pikës 6. të këtij vendimi, Obligohet Ministria e Shëndetësisë të bëjë shpalosje të veçantë në Pasqyrat Vjetore Financiare të vitit 2021, duke respektuar kushtet e kontratës së furnizimit dhe legjislacionin relevant për klasifikimin e informatave të ndjeshme.
9. Obligohet Ministria e Shëndetësisë, që pas secilit vendim të paradhënies sipas autorizimit të këtij vendimi, të njoftojë Kryeministrin e Republikës së Kosovës.
10. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/11  
Datë: 07.05.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 maj 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes për "Njohje të Kualifikimeve Akademike" ndërmjet 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor, Kosovës, Shqipërisë, Bosnje e Hercegovinës, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë.
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/11

Datë: 07.05.2021


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-183, për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 maj 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës zbaton sanksionet e vendosura nga Këshilli i Bashkimit Evropian, përmes vendimit (CFSP) 2013/184, të Këshillit të Bashkimit Evropian, të datës 22 Prill 2013 lidhur me disa masa restriktive bazuar në situatën në Myanmar/Burma, të ndryshuar dhe plotësuar me vendimet (CFSP) 2021/482 dhe (CFSP) 2021/483, të datës 22 Mars 2021, dhe vendimit (CFSP) 2021/639, të datës 19 prill 2021, ndaj tridhjetëepesë (35) zyrtarëve dhe dy (2) entiteteve të Myanmar/Burma, të përfshirë në abuzime dhe shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Myanmar/Burma.
2. Sanksionet e lartcekura konsistojnë në:
  - 2.1. Ngrirje të aseteve në Republikën e Kosovës për individët dhe entitetin e sanksionuar;
  - 2.2. Ndalim të udhëtimit për individët e sanksionuar, dhe
  - 2.3. Ndalim për persona dhe entitete në Republikën e Kosovës, që të vëjnë në dispozicion fonde, qoftë në mënyrë direkte ose indirekte, për individët dhe entitetet e sanksionuara.
3. Emrat e individëve dhe entiteteve ndaj të cilëve zbatohen sanksionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të përcaktuara si në pikën 2. të këtij vendimi, janë të listuara në Shtojcën nr. 1. e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Zbatimi i sanksioneve ndërkombëtare të përcaktuara me këtë vendim vlen deri me datën e përcaktuar në Vendimin (CFSP) 2013/184 të Këshillit të Bashkimit Evropian, të datës 22 Prill 2013 lidhur me masa restriktive kundër Myanmar/Burma, të ndryshuar dhe plotësuar me vendimet (CFSP) 2021/482 dhe (CFSP) 2021/483, të datës 22 Mars 2021 dhe vendimit (CFSP) 2021/639, të datës 19 prill 2021.
5. Obligohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



## SHTOJCA Nr. 1

Qeveria e Republikës së Kosovës, bazuar në Vendimin (CFSP) 2013/184 të Këshillit të Bashkimit Evropian, të datës 22 prill 2013 lidhur me disa masa restriktive kundër Myanmar/Burma, të ndryshuar dhe plotësuar me vendimet (CFSP) 2021/482 dhe (CFSP) 2021/483 të datës 22 mars 2021, dhe vendimit (CFSP) 2021/639 të datës 19 prill 2021, zbaton sanksione ndaj tridhjetë e pesë (35) zyrtarëve dhe dy (2) entitetëve të Mianmarit/Birmanisë, të përfshirë në abuzime dhe shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Mianmar/Birmani.

### 1. Individët:

- 1.1. Aung Kyaw Zaw, Komandant i Zyrës për Operacionet Speciale, Ushtria e Mianmar;
- 1.2. Maung Maung Soe, Komandant i Komandës Perëndimore të Forcave të Armatosura;
- 1.3. Than Oo, Komandant i Divizionit të 99 të Këmborisë së Lehtë;
- 1.4. Aung Aung, Komandant i Divizionit të 33 të Këmborisë së Lehtë;
- 1.5. Khin Matung Soe, Komandant për Operacione Ushtarake;
- 1.6. Thura San Lwin, Komandant i Policisë Kufitare;
- 1.7. Thant Zin Oo, Komandant i Batalionit 7 të Policisë;
- 1.8. Ba Kyaw, Rreshter në Batalionin e 564 të Këmborisë së Lehtë;
- 1.9. Tun Naing, Oficer Komandues i Policisë Kufitare;
- 1.10. Khin Hlaing, Komandant i Komandës së verilindjes;
- 1.11. Aung Myo Thu, Komandant i Njësisë Pushore të Batalionit të 33 të Këmborisë së Lehtë;
- 1.12. Thant Zaw Win, Major i Batalionit 564 të Këmborisë së Lehtë;
- 1.13. Kyaw Chay, Oficer i Policisë Kufitare;
- 1.14. Nyi Nyi Swe, Ish Komandant i Komandës Veriore;
- 1.15. Min Aung Hlaing, Komandant i Përgjithsëm i Armatës së Mianmarit;
- 1.16. Myint Swe, Gjeneral Lejtnantë i Armatës së Mianmarit;
- 1.17. Soe Win, Zëvendës Komandant i Përgjithsëm i Armatës së Mianmarit;
- 1.18. Sein Win, Ish Ministër i Mbrojtjes;
- 1.19. Thein Soe, Kryetar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- 1.20. Mya Tun Oo, Ministër i Mbrojtjes nga 1 shkurt 2021;
- 1.21. Dwe Aung Lin, Sekretar i Këshillit Administrativ të Shtetit;
- 1.22. Ye Win Oo, Gjeneral Lejtnantë i Armatës së Mianmarit;
- 1.23. Maung Maung Kyaë, Anëtar i Këshillit Administrativ të Shtetit;
- 1.24. Moe Myint Tun, Anëtar i Këshillit Administrativ të Shtetit;
- 1.25. Than Hlaing, Zv.Ministër i Punëve të Brendshme dhe Shef i Policisë;
- 1.26. Mahn Nyein Maung, Anëtar i Këshillit Administrativ të Shtetit;
- 1.27. Thein Nyunt, Anëtar i Këshillit Administrativ të Shtetit;
- 1.28. Khin Maung Swe, Anëtar i Këshillit Administrativ të Shtetit;
- 1.29. Aye Nu Sein, Anëtar i Këshillit Administrativ të Shtetit;
- 1.30. Jeng Phang Naw Htaung, Anëtar i Këshillit Administrativ të Shtetit;
- 1.31. Maung Ha, Anëtar i Këshillit Administrativ të Shtetit;
- 1.32. Sai Long Hseng, Anëtar i Këshillit Administrativ të Shtetit;
- 1.33. Saw Daniel, Anëtar i Këshillit Administrativ të Shtetit;

- 1.34. Dr Banyar Aung Moe, Anëtar i Këshillit Administrativ të Shtetit;
- 1.35. U Chit Naing, Ministër i Informacionit.

**2. Entitetet:**

- 2.1. Myanmar Economic Holdings Public Company Ltd;
- 2.2. Myanmar Economic Corporation Limited.





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 06/11  
Datë: 07.05.2021


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 paragrafi 6. të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 maj 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet rialokimi i mjeteve në shumë prej: 965,000€ në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal (MZHR) me kod 221, nën programi Administrata Qendrore me kod 11321, nga kategoria e shpenzimeve kapitale konkretisht nga projekti: "Programi për zhvillim rajonal", me kod 18782 në 17 (shtatëmbëdhjetë) projekte kapitale në përputhje me Marrëveshjet e Mirëkuptimit dhe Aneks-Marrëveshjen e Mirëkuptimit për projekte kapitale të nënshkuara nga Ministri i MZHR-së dhe Kryetarët e Komunave.
2. Mjete nga pika 1. e këtij vendimi rialokohen nga projekti: "Programi për zhvillim rajonal" me kod 18782 në këto projekte, me shumatat e cekura si në vijim:
  - 2.1. "Ndërtimi i rrugës së rendit të katërt me zhavorr në fshatin Skoqen, asfaltimi i rrugës në fshatin Taraxhë-Bruzniq, asfaltimi i rrugës në fshatin Samadrexhë-Dumnicë" - Vushtrri, në shumë prej 70,000.00€;
  - 2.2. "Qendra kulturore për komunitete" - Gjilan, në shumë prej 80,000.00€;
  - 2.3. "Ndërtimi i ujësjellësit në Gllarevë" - Klinë, në shumë prej 70,000.00 €;
  - 2.4. "Ndërtimi i Urave - fshati Bajçinë, fshati Gllamnik dhe fshati Sfeqël" - Podujevë, në shumë prej 60,000.00 €;
  - 2.5. "Ndërtimi i çerdhes për fëmijë" - Skenderaj, në shumë prej 80,000.00 €;
  - 2.6. "Ndërtimi i infrastrukturës në zona turistike - Parku i Pishave" - Ferizaj, në shumë prej 50,000.00 €;
  - 2.7. "Ndërtimi i tregut ditor në fshatin Ratkoc" - Rahovec, në shumë prej 50,000.00 €;
  - 2.8. "Shtrimi i rrugëve lokale me kubëza" - Mamushë, në shumë prej 50,000.00 €;
  - 2.9. "Shtrim me kubëza betoni i rrugëve në zonat rurale dhe urbane" - Hani i Elezit, në shumë prej 50,000.00 €;
  - 2.10. "Rregullimi i parkut atraktiv dhe sportiv te Pishat" - Shtime, në shumë prej 50,000.00 €;
  - 2.11. "Asfaltimi i rrugës kryesore dhe rrugëve hyrëse dhe ndërtimi i mureve mbajtës të betonit të armiruar në vendbanimin mëmë" - Zveçan, në shumë prej 50,000.00 €;
  - 2.12. "Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve në fshatin Kutllovc" - Mitrovicë Jugore, në shumë prej 50,000.00€;
  - 2.13. "Asfaltimi i rrugës Ramadan Xhokli -Koxhaj"- Kaçanik, në shumë prej 50,000.00 €;

- 2.14. "Ndërtimi i urës për këmbësor dhe biçikleta mbi lumin Erenik" - Gjakovë, në shumë prej 50,000.00 €;
- 2.15. "Vend - Pritjet (stacione) shumë funksionale" - Prizren, në shumë prej 75,000.00 €;
- 2.16. "Pumptrack" - Prizren, në shumë prej 40,000.00 €;
- 2.17. Projektit ekzistues "Zhvillimi socio-ekonomik në Komunën e Kamenicës - kanalizimi, me kod 15894 i ndahen mjete shtesë në shumë prej 40,000€, mbi bazën e Aneks-Marrëveshjes së Mirëkuptimit Nr. 325 të datës 17.03.2021.
3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 07/11

Datë: 07.05.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 18, paragrafi 1. të Ligjit Nr. 06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, dhe me qëllim të zbatimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Punës së Punës dhe Mirëqenies Sociale të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë për Mobilitetin në Punë, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 maj 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Lirohen nga obligimi për pajisje me Leje Pune Afatshkurtër për të huajt shtetasit e Republikës së Shqipërisë, që janë me qëndrim të ligjshëm në territorin e Republikës së Kosovës, të cilët gëzojnë të drejtën e punësimit dhe të vetëpunësimit.
2. Për të punësuarit sipas pikës 1. të këtij Vendimi vlejné të drejta dhe detyrime sipas legjislacionit përkatës në fuqi, sikurse për shtetasit e Republikës së Kosovës.
3. Obligohen të gjitha institucionet kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/11

Datë: 07.05.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 49 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë, nenit 23 paragrafi 5 të Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 maj 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Nr. 02/54 të datës 30.12.2020**

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 1.2 dhe 1.3 e Vendimit të Qeverisë së Kosovës Nr. 02/54 të datës 30.12.2020 për emërimin e Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, si në vijim:
  - 1.2. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, anëtar;
  - 1.3. Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Mbrojtjes, anëtare.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 09/11

Datë: 07.05.2021


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 9, 10, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 maj 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim shtesë për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projekteve të infrastrukturës rrugore që janë në ndërtim e sipër me financim nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për:
  - Zgjerimin e Rrugës Nacionale N2 Segmenti "Hyrja në Qytetin e Ferizajit", Zonat Kadastrale: Perlez i Jerlive, Muhoc, Talinoc i Jerlive, Talinoc i Muhaxherëve dhe Ferizaj, Komuna Ferizaj;
  - Zgjerimin e Rrugës Nacionale R 107, Segmenti "Hyrja në Qytetin e Prizrenit" Zona Kadastrale: Dushanovë, Komuna Prizren;
  - Zgjerimin e Rrugës Nacionale N25.2 "Hyrja në Qytetin e Gjilanit" Zona Kadastrale Gjilan, Komuna Gjilan dhe Koretishtë, Komuna Novobërdë;
  - Rehabilitimin e Rrugës Nacionale N25.3 Segmenti "Killokot - Gjilan" Zona Kadastrale Partesh, Komuna e Parteshit, sipas tabelave të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kritereve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Komunitat Gjilan, Ferizaj, Prizren, Novobërdë dhe Partesh.

4. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë